



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 251, dt.04.11.2016

Në mbështetje të nenit 17, pika 3, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit”, në mbledhjen e dt. 04.11.2016 Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi kërkesën për dhënie license në fushën e restaurimit për Shoqërinë “ARIFAJ” shpk, me drejtues teknik ark. Ervin Panidha (RP 67),

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Shoqërisë “ARIFAJ” shpk me drejtues ligjor Znj. Rezearta Bokçiu për pajisje me licensë restaurimi për kategorinë “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik ark. **Ervin Panidha**.
2. T’i propozojë Ministrit të Kulturës, miratimin e kërkesës për pajisje me licensë restaurimi për Shoqërinë “ARIFAJ” shpk, për kategorinë “CZ. Zbatim për punimet e restaurimit në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi” me drejtues teknik ark. **Ervin Panidha**.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI